



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

## THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

**Pozicioni: Specialist në Sektorin e Operimeve në Fluturim, në Drejtorinë e Standardeve të Fluturimit.**

### 1. Çfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës, bazuar në profesionalizëm dhe meritë.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë profesionistë të fushës, me eksperiencë në administratën publike ose/dhe sektorin privat.

### 2. Detyrat e pozicionit të punës

- a) Kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të asistuar Përgjegjësin e Sektorit të Operimeve në Fluturim(OPS) për Zbatimin në Shqipëri të SARPS-ve përkatëse të përfshira në Aneksin 6, Aneksin 9, Aneksin 18, dhe Aneksin 19 të ICAO-s si edhe kryen përditësimet e nevojshme.
- b) Përgatit mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen efikase dhe efektive të Operatorëve të transportit ajror sic janë Manuali i Inspektorëve, Listat e Kontrollit, Formularët e Anketimit dhe Forma e Auditit dhe i bëjnë ato lehtësisht të disponueshme në sektor. Kjo duhet të përfshijë mjetet për inspektime efikase dhe certifikim fillestar të operatorëve ajror, mbikëqyrjen vjetore të vazhdueshme dhe inspektimet në fluturim.
- c) Rishikon të gjithë manualet, procedurat e shkruara dhe manualin e lëshuar nga DFS në lidhje me sigurinë në operim dhe përditëson sipas nevojave.
- d) Mbështet Përgjegjësin e Sektorit të Operimeve në Fluturim(OPS) në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të autorizuar/certifikuar Operatorët e Transportit Ajror në përputhje me rregulloret e aplikueshme, procedurat e shkruara dhe direktivat e tjera përkatëse të lëshuara nga ACAA.
- e) Mbështet Përgjegjësin e Sektorit të Operimeve në Fluturim(OPS) me veprimet e nevojshme për të lëshuar, rinovuar, ndryshuar, pezulluar ose anuluar Certifikatat/Autorizimet e Operatorëve të Transportit Ajror të Miratuara sipas rastit.
- f) Siguron mbikëqyrje të vazhdueshme për operatorët e certifikuar/autorizuar të transportit ajror në mënyrë që të sigurohet që ata të ruajnë standardet e kërkuara të sigurisë në operim të specifikuar nga ACAA.
- g) Kryen inspektime në fluturim, në lidhje me kabinën e pasagjerëve dhe në operatorët e certifikuar për mallra të rrezikshëm.
- h) Merr masat e nevojshme për vendosjen e standardeve të sigurisë në operim në Shqipëri (sipas kërkesave të ICAO/EASA)

### 3. Kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës që duhet të plotësojë kandidati

**Kushtet që duhet të plotësoj kandidati janë:**

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të zotërojë gjuhën shqipe dhe angleze, të shkruar dhe të folur
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- e) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna nga institucionet publike apo private, ku ka ushtruar profesionin, e cila nuk është shuar sipas legjislacionit përkatës.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

## Kërkesat e pozicionit të punës

- Arsimimi:** Të paktën diplomë të nivelit Bachelor në një nga degët e Arsimit të Lartë.
- Eksperiencia në punë:** Të ketë të paktën 2 vite përvojë punë si Cabin Crew në kompanitë e transportit Ajror.
- Gjuhë e huaj:** Anglisht Niveli B2 (ose ekuivalente).

## 4. Dokumentacioni për dorëzim

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- Formën e aplikimit të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- Fotokopje të diplomës Bachelor.
- Fotokopje e librezës së punës.
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

## 5. Aftësi të kërkuara

- Ekspertize teknike:** Aplikon njohuritë teknike për të kryer aktivitetet mbikqyrëse në fushën e tij/saj të ekspertizës.
- Inisiativë:** Identifikon dhe adreson çështjet në mënyrë të pavarur, proaktive dhe të vazhdueshme për të arritur objektivat.
- Zgjidhjen e problemeve:** Zgjidh problematikat me nivele të ndryshme kompleksiteti dhe rreziku. Merr vendime në kohën e duhur duke konsideruar detyrat, faktet, objektivat, rreziqet dhe konfliktet.
- Të menduarit në nivel sistemi:** Kupton dhe përcakton se si component të ndryshme ndërveprojnë dhe afektojnë systemin e performancës së rreziqeve në operim (safety).
- Udhëheqja dhe puna në grup:** Bashkëpunon në të gjitha nivelet e organizatës brenda dhe jashtë drejtorisë/sectorit për të promovuar vizionin dhe objektivat. Bën të mundur që stafi në varësi të tij të arrijë këto objektiva.

## MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

- Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**;
- Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**.

**Kandidati me rezultatet më të larta (por jo më pak se 70 pikë) shpallet fitues, ndërsa kandidatët që marrin të paktën 70 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen në listë pritje.**



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

## **REZULTATET E VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT**

### **Rezultate e vleresimit të dokumentacionit.**

Në datën **08/05/2023**, Autoriteti i Aviacionit Civil do të shpall një faqen e tij zyrtare të internetit, listën e kandidatëve të kualifikuar për intervistë, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës, si dhe vendin dhe datën e zhvillimit të intervistës.

Kandidatët të cilët nuk janë kualifikuar për intervistë mund të kërkojnë informacion me e-mail në adresën zyrtare [rekrutime@caa.gov.al/](mailto:rekrutime@caa.gov.al) , për aryet e moskualifikimit.

### **Shpallja e rezultatve të konkurimit.**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë), Autoriteti i Aviacionit Civil, do të njoftojë individualisht me e-mail çdo kandidat për rezultatin e pikëve.

Kandidatët të cilët nuk janë dakort me rezultatin, kanë të drejtë të paraqesin ankim me e-mail pranë Autoritetit në adresën zyrtare [rekrutime@caa.gov.al/](mailto:rekrutime@caa.gov.al). Afati i ankimit është **5 ditë** kalendarike nga data e njoftimit individual.

Autoriteti pas përfundimit të afatit të ankimit do të shpallë fituesin në faqen e tij të internetit.

### **APLIKIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT**

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni dhe të dorëzoni dokumentat e kërkuara (të skanuara) në adresën zyrtare [rekrutime@caa.gov.al/](mailto:rekrutime@caa.gov.al) .

**Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit shtyhet deri më datë 08.05.2023, ora 12:00 (mesditë).**